




www.lezha.gov.al

bashkia ime

Botim i Bashkisë Lezhë, Nr. 8, shkurt 2018



Kujtohet 17 janari - 550-vjetori i Gjergj Kastriotit - Skendërbeut




"Bashkitë në Europë" në Lezhë, Fq. 8

Mbylljen aplikimet për ReLOAd, fq 9

Qindra familje në Lezhë pa ndihmë, fq 12

Uldedaj, Kampion në Gjermani, fq 19



Redaksia

Drejtoria e Integrimit në BE dhe Programeve të Zhvillimit
Lajmet: Altin Mema, Rrok Lelçaj, Gjergj Figuri
Fotot: Olsi Tetaj
Redaktorë: Hekuran Koka, Xhulia Lekaj
Design: Hekuran Koka, Evaristo Coli
www.lezha.gov.al, pzhvillimi@lezha.gov.al

Rreth 38 kilometra vijë bregdetare, male, lumi e laguna, histori, arkeologji dhe një trashëgimi e pasur kulturore... Lezha mund t'i ofrojë të gjitha në një paketë të plotë turistike.

Mblidhet Këshilli, miratohet buxheti 2018	4
17 janari - 550-vjetori i vdekjes së Skendërbeut	6
“Bashkitë për në Europë” vjen në Lezhë	8
Mbyllen aplikimet për ReLOaD	9
"Bëjmë detyrat në shkollë" fillon edhe në Lezhës	10
Bashkia Lezhë, takim me bizneset e turizmit	11
Qindra familje në Lezhë pa ndihmë	12
Qendrat Komunitare japin efektet e para	13
Nis aksioni për pastrimin e territorit	14
Bibliotekën e lëvizshme edhe në 2018	15
Çelet ekspozita e piktorëve Mashi dhe Mallunxa	16
Preç zogaj promovon në Lezhë librin “IN LOVE”	17
Festohet në Lezhë 10 vjetori i Pavarësisë së Kosovës	19
Jurgen Uldedaj, Kampion në Gjermani	19

Mbledhet Këshilli Bashkiak i Lezhës

Nën drejtimin e kryetarit Kristian Gjiodaj është mbledhur Këshilli Bashkiak i Lezhës. Fillimisht Gjiodaj ftoi të gjithë anëtarët e pranishëm të mbajnë një minutë heshtje për ish-anëtarin e këtij këshilli Aleksandër Ndo-ka i cili u nda nga jeta në fundvitin e kaluar. Pas këtij homazhi një grup deputetësh të majtë braktisën sallën e mbledhjes, me pretendimin se këshilli aktual i Bashkisë është ilegjitim. Në këtë mbledhje ishte prezent dhe kreu i Bashkisë së Lezhës zoti Fran Frrokaj. Së pari, me shumicë votash Këshilli bëri zëvendësimin e dy keshilltarëve nga krijimi i vendeve vakante. Kështu në vend të Këshilltarit Aleksandër Ndo-ka, bëri betimin Nikoleta Kolaj dhe në vend të Lindit Preçit, që ka dhënë dorëheqjen, mandati i kaloi Suri Damzit.

Më pas, me shumicë votash Këshilli shqyrtoi dhe miratoi një sërë projektvendimesh që kishin të bënin me dhënien e ndihmës ekonomike për periudhën 1- 31 Janar 2018 dhe dhënien e pagesës për personat me aftësi të kufizuar. Zëvendëskryetarja e Bashkisë dhe njëherësh drejtoresha e Shërbimit Social Alfrida Marku bëri një panoramim të punës së kësaj drejtorie duke sqaruar hollësisht për procedurat që ndiqen për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Duke ju dhënë përgjigje transparente pyetjeve të anëtarëve të Këshillit, ndërhyri dhe kreu i Bashkisë Zoti Frrokaj, i cili, sipas ligjit argumentoi çdo paqartësi. Përfundimi i procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ZRPP, shqyrtimi



Miratohet buxheti 2018, diskutime për reformën e ujit

e miratimi i projektvendimit për miratimin e taksave dhe tarifave vendore si dhe shqyrtimi e miratimi i projektvendimit për miratimin e projektbuxhetit për vitin 2018 dhe të programit buxhetor afatmesëm 2018-2020, ishin pika të tjera të rëndësishme të rendit të ditës që u miratuan me shumicë votash nga Këshilli Bashkiak. Gjatë diskutimit e shqyrtimit të këtyre pikave kreu i Bashkisë Frrokaj tregoi gatishmëri për të sqaruar deri në detaj çdo problem dhe paqartësi. Ndërkohë, Frrokaj argumentoi para anëtarëve të këshillit projektin për ndërtimin e varrezave të reja publike, që parashikohet të jenë në vendin e duhur dhe që plotësojnë gjithë nevojat e Lezhës për një periudhë afatgjatë. Kryetari i Bashkisë Lezhë i dha përgjigje dhe shumë pyetjeve që lidheshin me reformën e ujit, ku shumë familje, prej vitesh, janë penalizuar me fatura afrofe. Për këtë problem, Frrokaj sqaroi publikisht anëtarët e këshillit dhe përmes tyre gjithë familjet që kanë të tillë problem, se asnjëra syresh që nuk ka të lidhur një kontratë të rregullt ligjore me Ujësjellës – Kanalizime, nuk do të paguajë asnjë lek. Këshilli Bashkiak dhe anëtarët e tij, diskutuan, bënë vërejtje e sugjerime ku drejtues e specialistë të drejtorive pranë Bashkisë Lezhë iu përgjigjen pyetjeve dhe argumentuan hollësisht për gjithëçfarë u parashtrua aty, duke u dhënë zgjidhje problemeve të ngritura.



Përkujtohet në Lezhë 550-vjetori i vdekjes

Është përkujtuar në Lezhë 550 - vjetori i vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skendërbeut. Me këtë rast, në memorialin që ruan vendvarrimin e heroit, drejtues të pushtetit vendor dhe institucioneve, përfaqësues të partive politike e besimeve fetare, nxënës shkollash, qytetarë të Lezhës, bënë homazhe e vendosën tufa me lule. Në këtë përvjetor ishin të pranishëm dhe shqiptarë nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi si dhe 150 arbëresh të ardhur nga Italia e jugut. Kryetari i bashkisë Fran Frrokaj në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se, kjo ditë shënon përmbylljen e një prej periudhave më të shndritshme të historisë sonë, kur shqipëria iu imponua europës si mbrojtëse e qytetërimit dhe civilizimit të saj dhe Gjergj Kastrioti hyri në historinë e mesjetës si një ndër gjeneralët më të mëdhenj



të epokës së vet, si strateg i luftës dhe profet i paqes. Sot, Lezha përkujton një datë historike që ruhet në memorien e të gjithë shqiptarëve, jo thjesht si një datë kur heroit mbylli sytë, por si një përjetësim i veprës madhështore të tij, si një trashëgimi e vyer e trimërisë dhe urtësisë, vlera këto që na bëjnë të ndjehemi krenarë që jemi trashëgimtar të Gjergj Kastriotit, njeriut simbol të bashkimit të kombit që diti të arrijë konsensusin e princave hatërmbetës, duke u bërë baza e themelit të shtetit. Mbetet dëshmi e pakontestueshme lidhja historike e Gjergj Kastriotit me Lezhën dhe Besëlidhjen e saj. Si luftëtar i lirise, diplomat, burrë i madh shteti dhe mit i pavdekshëm në memorien e gjithë shqiptarëve, Skenderbeu mbetet epokal.

Në këtë përvjetor të vdekjes së heroit, duke



së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

ngritur lart figurën e Skënderbeut, përcollën mesazhet e tyre të paqes, mirësisë, tolerancës dhe bashkëjetesës vëllazërore, arqipeshkvi i Shkodër-Pult monsijor Anxhelo Masafra dhe myftia i xhamisë Lezhë Agim Tereziu. Me mjaft interes u prit dhe përshëndetja në gjuhën shqipe e përfaqësuesit të arbereshëve Giorgo Cuccia, i cili pasi vlerësoi figurën e Skënderbeut, falenderoi bashkinë dhe kreun e saj Frrokaj për ftesën dhe pritjen tepër vëllazërore që iu rezervuan. Në mjediset e vendvarrimit të heroit ishin ekspozuar dhe libra të rrallë e botime të tjera kushtuar Gjergj Kastriotit, të cilët u mundësuan nga bashkëpunimi mes bibliotekës “Gjergj Fishta” Lezhë dhe Bibliotekës Kombëtare. Me këtë rast në galerinë e arteve figurative u hap ekspozita me punime të pik-



torëve të Lezhës kushtuar figurës së Gjergj Kastriotit - Skenderbeu, At Gjergj Fishtës dhe Shenjtores Nënë Tereza. Aktivitetet e kësaj dite të organizuara nga Bashkia Lezhë, vijuan me një koncert muziko-letrar të përgatitur nga grupet artistike të pallatit të kulturës dhe shkolla “Gjergj Kastrioti”, ku këngët, recitimet, veprimet koreografike e krijimet e tjera letrare i bënë jehonë figurës së ndritur të heroit të kombit tonë, simbolit të bashkimit të shqiptarëve, Gjergj Kastriotit - Skënderbeu. Sipari i veprimtarive të kësaj dite mbyllet me premierën tre dimensionale “Gjergj Kastrioti - Skënderbeu” organizuar nga Qendra Kulturore e Fëmijëve “Gjergj Laca”, nxënësit e Qendrës së Zhvillimit Ditor dhe ata të shkollës “Lezha Academic Center”.



“BASHKITË PËR NË EUROPE” VJEN NË LEZHË

Është zhvilluar në Lezhë trajnimi i parë i koordinatorëve lokalë të EU Desks- Zyrat për çështjet e Bashkimit European, në kuadër të Projektit “Bashkitë për në Europë”. Axhenda e këtij trajnimi u fokusua edhe tek media dhe marrëdhënjet me publikun. Ky program ka si qëllim rritjen e kapaciteteve për të përcjellë sa më qartë te qytetarët informacionin e duhur për Bashkimin European, standartet dhe kriteret që vendet kandidatë për anëtarësim duhet të plotësojnë për të qenë pjesë e këtij bashkimi si dhe ndryshimet që vijnë pas anëtarësimit në nivelin ekonomik dhe social. Ky projekt vjen si domosdoshmëri pasi shumë qytetarë kanë ende paqartësi, ashtu sikurse janë të shumtë ata që e kanë të qartë se Bashkimi European para së gjithash është i lidhur me respektimin e ligjit, cilësinë e jetës, me një komunitet që

kujdeset për të gjithë anëtarët e tij në mënyrë të barabartë. Ishte e pranishme në këtë takim trajnues edhe zv.kryetarja e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku, e cila foli për marrëdhënje bashkëpunimi e ndërveprimi, për komunikim e përballje mes koordinatorëve të bashkisë dhe qytetarëve në marrjen e informacionit. Ky projekt po realizohet në kuadër të programit rajonal për Demokraci Vendore (ReLOaD)

Ai ka si qëllim që të aftësojë përfaqësuesit e organizatave të shkruajnë, zbatojnë dhe monitorojnë projekte sipas standardeve të Bashkimit Evropian. Ky trajnim po bazohet në metodologjinë për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile, ku do të bazohet zbatimi i projekteve të mbështetura nga Programi Rajonal, ReLOaD, “Bashkitë për në Europë”.



Mbyllen aplikimet për thirrjen e parë ReLOaD në Bashkinë Lezhë

Me datë 12 shkurt 2018, në orën 15:00, Zyra e Protokollit në bashki përmylli pranimin dorazi të projekt propozimeve për programin ReLOaD pas hapjes së thirrjes për projekt propozime që Bashkia Lezhë kishte shpallur që më datë 8 janar 2018. Gjithsej u dorëzuan dorazi 17projekte, ndërkohë që bashkë me 10 projektet që kanë ardhur me postë, kjo thirrje përmyllet me 27 aplikime për projekte në këtë thirrje, shumë më tepër edhe nga parashikimet më optimiste. Kjo gjë dëshmon edhe njëherë bashkëpunimin e ngushtë të Bashkisë Lezhë me një numër të madh aktorësh nga shoqëria civile, të cilët duan të vazhdojnë dhe të thellojnë bashkëpunimin me këtë bashki.

Gjatë gjithë muajit, specialistët e Drejtorisë së Integritit European dhe Programeve të Zhvillimit, por edhe nga drejtoritë e tjera kanë qënë të angazhuar në konsulencë të vazhdueshme ndaj OSHC-ve, qoftë për përgjigje teknike, qoftë për orientime, ndihmë me statistika dhe informacione të ndryshme. Çështjet e ngritura, si pranueshmëria e aplikantëve, vlefshmëria e dokumentave etj, janë drejtuar në zyrën e menaxhimit të projektit ReLOaD në Tiranë, gjithashtu edhe në zyrën Qëndrore të këtij projekti në Sarajevë. Këto pyetje janë jo vetëm ndihmëse për organizata, por do të ndihmojnë edhe vetë programin ReLOaD që të ndërhyjë në përmirësimin e metodologjisë për thirrjet e tjera.

Në ditët në vijim do të mblidhet komisioni i vlerësimit, i cili do të vlerësojë ligjshmërinë dhe rregullsinë e aplikimeve dhe aplikantëve si fillim, dhe më pas do të vazhdojë punën me vlerësimin e projek-

teve duke parë edhe volumin e madh të projekteve. Kjo punë do të zgjasë, por me angazhimin e plotë të komisionit do të arrihet që brenda afatit të parashikuar në thirrje, të nxirren rezultatet në mënyrë që në prill të gjitha projektet të kenë nisur punën për aktivitetet e tyre.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Shqipëri (UNDP- PNUD), në kuadër të Programit Rajonal mbi Demokracinë Vendore (ReLOaD) financuar nga Bashkimi European ka përzgjedhur 12 bashki në Shqipëri të cilat janë pjesë e skemës së grantit të Projektit me një vlerë prej rreth 100.000 Euro për secilën bashki për një periudhë rreth 30 mujore. Kjo skemë granti do të shërbejë direkt për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, të cilat do të ofrojnë shërbime në përputhje me prioritetet e bashkisë përkatëse. Granti do të menaxhohet në bashkëpunim ndërmjet bashkisë së përzgjedhur dhe zyrës së UNDP në Tiranë.



Empowered lives. Resilient nations.

"Bëjmë detyrat në shkollë" fillon në shkollat e Lezhës

Bashkia Lezhë është një ndër 5 bashkitë që pranuan t'i bashkangjiten këtij projekti duke nënshkruar marrëveshjen me qeverinë për zbatimin e këtij projekti pilot.

Në Bashkinë Lezhë shkollat ku do të zbatohet projekti janë dy shkollat e përzgjedhura në bashkëpunim me DAR-Lezhë,

- Shkolla "Besëlidhja"
- Shkolla "Gjergj Fishta"

Projekti ka filluar dhe Bashkia Lezhë ka mundësuar "Kantinat Ushqimore", sigurinë dhe pastërinë, fillimisht është aplikuar qendrimi në shkollë ku nxënësit kane konsumuar bukën të marrë me vete. Projekti parashikon që në kantinat ushqimore t'ju ofrohet nxënësve ushqim i shëndetshëm dhe i kontrolluar sipas një menyje ditore që ndryshon çdo dite të propozuar nga MBZHR ose bashkite dhe miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Në pamundësi për të hartuar një meny, Bashkia Lezhë ka përdorur mënyre të sugjeruar nga MBZHR (Ministria e Bujqësisë) dhe Bashkia Tiranë.

Kemi kontaktuar disa biznese në Lezhë për çmimin e vaktit të drekës dhe mënyrën e ofrimit të shërbimit, interes ka shfaqur vetëm një biznes që operon me catering (Meridiani Catering) i cili ka pranuar të ofrojë ushqimin në të dy shkollat me çmim 160 lekë për nxënësit për një vakt me kushtin që numri i nxënësve që do të marrin ushqimin të jetë mbi 500 nxënësit në të dy shkollat së bashku.

Bashkë me DAR Lezhë javën që shkoi kemi zhvilluar takimet me prindërit për të ndarë me ta

idenë e projektit dhe mënyrën e ofrimit të ushqimit të cilin do ta paguajnë vetë prindërit.

Bashkia Lezhë në një moment të dytë do të shohë mundësinë e ndihmës për familjet në nevojë (me ndihmë ekonomike) premtim i kryetarit.

Së bashku me DAR Lezhë kemi zhvilluar tre takime me prindërit në këto dy shkolla.

Pas takimeve kanë konfirmuar se për momentin kanë pranuar idenë e ushqimit në kantinat ushqimore në shkollë rreth 200 nxënës gjithsej ose 16%.

Nga shkolla "Besëlidhja" e cila ka gjithsej 749 nxënës kanë pranuar të ushqehen në shkollë vetëm rreth 160 nxënës, pra 21%.

Nga shkolla "Gjergj Fishta" e cila ka gjithsej 540 nxënës kanë pranuar rreth 50 nxënës, pra 9%.

Pretendimet e prindërve për të mos u bërë pjesë e projektit janë:

- Shkolla nuk i mban nxënësit deri në orën 16:00 (kryesisht klasat e arsimit fillor), dhe prindërit detyrohen t'i marrin fëmijët rreth orës 13 e 30.
- fëmijët vijnë të lodhur dhe të djersitur nga shkolla.
- Në shkollë nuk i ndihmon kush të bëjnë detyrat (mësuesit janë në klasa kryesisht për të ruajtur qetësinë)
- disa prindërit janë në vështirësi ekonomike dhe nuk kanë mundësi pagese për ushqimin.

Në shkollat e tjera nuk kemi mundësi ta aplikojmë projektin sepse nuk kemi ambjente për kantinë ushqimore.

Bashkia Lezhë, takim në Shëngjin me bizneset e turizmit

Për t'u paraprirë punëve, me synimin për të patur një sezon turistik sa më cilësor dhe përfaqësues, Bashkia e Lezhës organizoi në Shëngjin një takim me përfaqësues të biznesit që operojnë kryesisht në sektorin e turizmit. Problematikat e këtij sektori me rendësi zhvillimi ekonomik për Lezhën, kanë qënë tema kryesore e diskutimeve. Drejtori i Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ardian Laçi, theksoi se në sajë të një planveprimi dhe koordinimi të përbashkët mes Bashkisë Lezhë dhe biznesit, presim këtë vit një turizëm më përfaqësues, më elitare dhe me të ardhura më të mëdha. Përgjegjësi i sektorit të Turizmit Gjergj Figuri, vuri në dukje faktin se për të patur një turizëm që funksionon në mënyrë të kontrolluar është i nevojshëm aplikimi i një plani konkret që përcakton prioritetet dhe mënyrat e zhvillimit, që duhet të jenë në përputhje me kapacitetet, mundësitë dhe planin e bashkisë për këtë sektor. Me resurset turistike që administrojnë, Bashkia e Lezhës i ka të gjitha mundësitë që të zhvillojë një turizëm gjithëvjeter.

Më pas, biznesmenë të ndryshëm diskutuan, bënë pyetje e sugjerime në dobi të zhvillimit të turizmit bregdetar, malor, historik e atij kuturor. U evidentuan problemet e vitit të

kaluar dhe nevojat ku duhet ndërhyrë këtë vit.

I pranishën në këtë takim, kreu i Bashkisë Lezhë, z.Fran Frrokaj, duke iu përgjigjur pyetjeve dhe interesit të biznesit, foli për masat që ka marrë bashkia dhe njësitë administrative në pastrimin e territorit dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj turistike në përgjithësi. Frrokaj, theksoi se me miratimin e buxhetit të këtij viti, do të bëhet një shpërndarje e drejtë, ku sektori i turizmit dhe Shëngjini do shikohet me përparësi.

Zhvillimi i turizmit, u tha në këtë takim, veç të tjerash, duhet parë në mundësinë e rritjes së frymës së bashkëpunimit bashki-biznes.



Mjerim në familjet e perjashtuara nga ndihma ekonomike

Përrjashtimi pa të drejtë nga ndihma ekonomike, rëndon gjendjen ekonomike dhe sociale të qindra familjeve në Bashkinë Lezhë.

Deri në muajin dhjetor 2017, në 10 njësitë administrative të Bashkisë Lezhë, janë trajtuar 1598 familje të vlerësuara në kushte nevojë apo nevojë ekstreme, familje që nuk kanë të ardhura apo kanë të ardhura të pamjaftueshme për të plotësuar kushtet bazë të jetesës. Me fillimin e zbatimit të Sistemit të Ri të ndihmës ekonomike, numri i familjeve të trajtuara me ndihmë ekonomike është përgjysmuar, duke rënë në 818 familje. Asnjë sqarim zyrtar për këto familje, asnjë arsye e argumentuar mbi kriteret pranuese apo kushtet përjashtuese nga skema e ndihmës ekonomike.

Formula e unifikuar e pikëzimit e deklaruar si risi e këtij sistemi është jo transparente dhe e njëanshme për sa kohë nuk detajon pikët e vlerësuara për çdo zë të deklarimit si dhe nuk u komunikon qytetarëve zyrtarisht mbi minimumin e pranueshmërisë në skemën

e ndihmës ekonomike.

Bashkia Lezhë ju bën thirrje strukturave të Shërbimit Social Shtetëror që në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore si dhe në emër të interesit më të lartë qytetar, ndihma ekonomike të shkojë te familjet më në nevojë dhe që realisht e meritojnë.

Familjet që vizitua sot janë secila në kushte të mjerueshme jetese, në mungesë edhe të nevojave minimale jetike. Të gjitha të përjashtuara padrejtësisht nga skema e ndihmës ekonomike, ndonëse punëkërkuar të papunë të regjistruar pranë Zyrës së punës, me probleme shëndetësore deri edhe në trajtim me pagesë pa aftësi, me 2 ose më shumë fëmijë të mitur, në pamundësi edhe për të blerë ilaçet, të rikthyer nga emigracioni, në kushte strehimi që përbëjnë rrezik për jetën.

Të gjitha këto familje kanë qënë përfituese të rregullta të ndihmës ekonomike dhe padrejtësisht u është mohuar kjo e drejtë.



Qendrat Komunitare japin efektet e para

Në njëren nga dy Qendrat Komunitare të Bashkisë Lezhë, në 6 muaj nga koha e vënies në funksion të saj, janë trajtuar 300 individë me probleme sociale. Këtë fakt e bëri të ditur zëvendëskryetari e Bashkisë Lezhë Alfrida Marku në një takim me përfaqësues të institucioneve e organizatave të shërbimeve sociale që operojnë në Lezhë. Marku argumentoi dhe bashkëpunimin e frutshëm mes këtyre qendrave komunitare dhe shërbimit social pranë Bashkisë Lezhë, një praktikë pune mjaft efikase për personat në nevojë. Ndër-

kohë, znj. Marku u ndal edhe tek procedurat e përfitimit të ndihmës ekonomike, duke theksuar se përkrahja financiare do të ketë si destinacion familjet që janë vërtetë me probleme ekonomike. Prej 6 muajsh të dy këto qendra komunitare multifunktionale janë vënë në funksion të shtresave në nevojë të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e fëmijëve, fuqizimin e familjes si dhe shërbimet edukative, praktika këto që, si në Lezhë, po implementohen me sukses edhe në disa bashki të tjera të vendit.



Nis aksioni për pastrimin e territorit të Bashkisë Lezhë

Në kuadër të planit kombëtar për një “Shqipëri të Pastër” ka nisur në Lezhë aksioni për pastrimin e gjithë territorit. Drejtues të institucioneve e punonjës të administratës publike, mësues e nxënës shkollash, janë bërë pjesë e këtij aksioni, duke ndërhyrë në rrugët, sheshet e shetitoret e qytetit, por dhe në zona të tjera problematke të njësisve administrative. Bashkia dhe Prefektura, me administratat e tyre, po i paraprijnë këtij aksioni me impakte pozitive në mjedis dhe turizëm. Deri në përmbylljen e tij, ky aksion do kalojë në disa faza. Drejtori i Programim Zhvillimit, Petrit Marku, bën të ditur se, në bashkëpunim me institucionin e Prefektit dhe gjithë administratën publike është hartuar një plan veprimi për të ndërhyrë edhe në pastrimin e bregdetit dhe në çdo cep të territorit të Bashkisë Lezhë. Faza e dytë e këtij aksioni do vijojë në fillim të javës që vjen me pastrimin e territorit në Njësinë Administrative të Shënkollit, Kolshit e të Shëngjinit, për të vijuar kështu edhe në njësitë e tjera. Punohet me objektiva të qarta ”Për një Lezhë sa më të pastër”.





Ekspozita e piktorëve Ardian Mashi dhe Bujar Mallunxa në Lezhë

Ekspozita e piktorëve Ardian Mashi dhe Bujar Mallunxa, e çelur në galerinë e arteve figurative të Pallatit të Kulturës, është pjesë e aktiviteteve artistike që po organizon Bashkia e Lezhës në Vitin Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit - Skënderbeu.

Piktorët Mashi dhe Mallunxa kanë ekspozuar 53 vepra, nga këto, 26 piktura në teknikën e vajit, 5 piktura në akuar-el, 19 piktura në pastel dhe 3 vizatime. Në këto punime spikasin gjinitë e peisazhit, natyrës së qetë dhe portretit. Në ceremoninë përuruese të kësaj ekspozite, përgjegjësi i galerisë, skulptori Ymer Metaliaj vlerësoi në detaje punët e paraqitura të dy piktorëve, të cilët në fillimet e para të këtij profesioni ishin shokë të një kursi, të një banke.

Ndërsa drejtori i Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit Ardian Laçi, evidentoi kujdesin dhe mbështetjen e Bashkisë Lezhë në inkurajimin dhe promovimin e piktorëve dhe talenteve krijues. Me nota pozitive u shprehën deputetja e Lezhës Lindita Metaliaj dhe gazetari Martin Deda, të cilët vunë në dukje angazhimin që ka bashkia dhe kreu i saj zoti Frrokaj në mbështetjen dhe promovimin e piktorëve e artistëve të të gjitha zhanreve të artit. Ekspozita po vizitohet me interes nga artistë, krijues e qytetarë të Lezhës.



Edhe 2018 fillon me Bibliotekën në të gjitha shkollat

Biblioteka "Gjergj Fishta" e nisi vitin me poezinë e autorit Tonin Nikolli nga përmbledhja e tij e fundit "Në oborr të Shiut". Miqtë e tij të shumtë i përcollën poezitë nën tingujt e violinës së mjeshtrit Flamur Toska dhe interpretimin e aktores së njohur të Teatrit Migjeni të Shkodrës znj. Merita Smaja. Ndërkohë vazhdon me kalendar të rregullt Biblioteka Shëtitëse në çdo shkollë të zonës rurale të Lezhës. Që nga fillimi i këtij viti Biblioteka është pasuruar me rreth 5000 ekzemplarë të rinj librash, si dhuratë e programit "E diela Shqiptare" në TV Kombëtar Klan, në përgjigje të vlerësimit të praktikës së bibliotekës shëtitëse, si një model që Ministria e Kulturës synon të kthejë në kombëtar. Ministria e Kulturës znj. Mirela Kumbaro shërbeu personalisht libra nga makina e Bibliotekës sonë Shtëtitëse, për nxënësit e Blinishtit.

Që nga janari Makina e Librave ka shkuar në shkollat e fshatrave Kolajak, Kolsh, Manati, Mabe, Grash, Dajc, Blinisht, Spiten, Tresh, Pllane, Kalivac, Ungrej,



Shengjin e Ishull Shengjin, Zejmen, Barbulloje dhe Rrile, ku me nxënësit kanë mbetur 652 libra, për t'i lexuar në muajin në vazhdim. Udhëtimi vazhdon me shumë libra të rinj, për të gjetur çdo ditë lexues të rinj, me dëshirën e zgjuar për të njohur historitë nëpër faqe librash; si Mario I vogël... Mario jeton në Kalivac, është 5 vjeç dhe nuk di të lexojë, por përrallat do t'ia lexojë motra. Ai do t'i mësojë përmendësh e "do t'jua tregoj vetëm shoqeve"

Njëkohshëm Biblioteka "Gjergj Fishta", mirëpret anëtarët dhe lexuesit e saj, miq të vjetër e shumë të rinj... Vetëm në një muaj janë regjistruar mbi 400 anëtarë në bibliotekë; 226 fëmijë dhe 212 anëtare në sallën e librit shqip. Tani kemi mysafirë edhe nxënësit nga shkollat jashtë qytetit, të cilët vijnë të njohin Shtëpinë e madhe të Librave, siç erdhën nxënësit e klasave të katërta të shkollës "Marash Gjoni" Rrilë. Jeni të mirëpritur në Bibliotekë, për të zbuluar një botë të madhe...!



Preç Zogaj promovon në Lezhë librin poetik "IN LOVE"

Në Lezhë poeti Preç Zogaj shkoi me librin e tij më të fundit "In Love". Në një ceremoni të thjeshtë ku shumë dashamirës të poezisë së tij lexuan pjesë nga poezitë në libër, poezi të cilat i cilësuan si "dashuritë njerëzore".

Lexues e adhurues të poezisë së Zogajt, artistë e krijues krijuan një auditor që pranoi të qëndronte edhe në këmbë kur gjimnazistët recitonin poezitë e librit "IN LOVE", njëqind e një poezi dashurie.

Poezia e Zogajt është komentuar si një ngjarje e rëndësishme që ndodh jo vetëm për Lezhën. Kryebashkiaku I Lezhës z. Fran Frrokaj, studiues, lexues dhe dashamirës të poezisë vlerësuan stilin e të shkruarit të poetit dhe shkrimtarit lezhjan Zogaj.

Zogaj në këtë libër poetik, përmes figurave të gjetura letrare jep mesazhe të qarta për dashurinë njerëzore. Kjo përzgjedhje poetike, si thuhet krejt poezia e Preç Zogajt, është një koleksion odësh moderne, ku klasi teknik, efektet poetike dhe finesa gjuhësore ofrojnë

diagramin e ndjeshmërive të një mendjeje refleksive që e sheh botën me sy lirik.

Prania në Lezhë për Zogajn, aty ku u krijua si poet, është një shenjë e dashurisë për qytetin dhe një detyrim për miqtë e rinj e të vjetër të shkollës poetike, ndaj edhe përzgjedhja nuk ka qenë krejt e rastësishme.

Nga vlerësimet e krijuesve të Lezhës dhe kritikës letrare, "In Love" është nga librat më të bukur poetikë botuar kohët e fundit. Poeti, siç shkruan kritiku Agim Basha në parathënie, hyn ndër ata poetë që e shohin poezinë si kapacitet të brendshëm të gjuhës.

Preç Zogaj hyn ndër ata poetë që e shohin poezinë si një apetit të qënies njerëzore të trashëguar nga praktikat e hershme të adhurimit. Edhe pse thellësisht personale, shumë poezi të tij apelojnë për një celebrim të hapur kolektiv ku mediumi, gjuha, është njëherësh skenë e festës dhe tempull i adhurimit. Ndaj lexuesi jo thjeshtë emocionohet, por humbet në guidën shpirtërore të mendimit poetik.



Festohet në Lezhë 10 vjetori i Pavarësisë së Kosovës

Qendra Kulturore e Fëmijëve "Gjergj Lacaj", në kuadër të 10- vjetorit të pavarësisë së Kosovës u angazhua me disa aktivitete në bashkëpunim me Shkollën Amerikane "Lezha Academy Centre" dhe Shkollën 9- vjeçare "Kosova". Ashtu si edhe në vitet e tjera shkolla "Kosova" ka organizuar një sërë aktivitete për përkujtimin e Pavarësisë së Kosovës, pasi kjo shkollë 9- vjeçare është kranre për emrin që mban.

Mësuesit e nxënësit e kësaj shkolle janë përgatitur për muaj të tërë me përkushtime dashuri në mënyrë që aktivitetet e tyre të jenë sa më të bukura, dhe të gjithë të pranishmit, prindër, qytetarë dhe të ftuar të tjerë t'i gëzohen jo vetëm pavarësisë së gjysmës së kombit, por edhe talentt të këtyre fëmijëve të mrekullueshëm. Shkolla "Kosova" me nxënësit e saj solli një program të larmishëm artistik plot këngë, recitime e pjesë ko-reografike, që i dhanë mjaft gjallëri sallës.

Këngët, vallet dhe inskenimet dramatrugjike e shoqëruan këtë aktivitet, i cili, këtë vit, ndryshe nga vitet e tjera, kishte edhe angazhimin e plotë të QKF- Lezhë dhe Shkollës Amerikane "LAC". Salla e madhe e QKF u bë shtëpia mikpritëse e aktivitetit e cila ofroi për fëmijët e moshave të vogla shfaqjen "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", një teatër i konceptuar me tre plane të ndryshme, shfaqje kukullash, pamje filmike, dhe aktivitete tematik-kulturor ku ndërthuren bukur tradicionalja dhe modernja duke sjellë kështu jetën dhe veprën e Heroit tonë Kombëtar për një audeincë të re dhe të etur për ta njohur hësitorinë e popullit të vet.

Gëzuar Kosovë!



Jurgen Ulledaj, Kampion Ndërkombëtar i Gjermanisë

Boksieri nga Lezha, Jurgen Ulledaj, ka fituar titullin "International German Championship" në boks, pasi mundi çekun Jakub Synek, të shtunën mbrëma, në datw 3 shkurt, në Halle të Gjermanisë. Në një meç të kategorisë Cruiser (90 kilogramë), shqiptari 21-vjeçar ka mposhtur çekun për të bërë të tijin titullin "International German Championship".

Ulledaj ishte fantastik për 10 runde, sidomos në atë të tetin kur edhe e rrëzoi kundërshtarin në tokë, por qëndrueshmëria e çekut përkundër goditjeve të pareshtura bëri që ndeshja të zhvillohej deri në rundin e fundit. Në përfundim të 10 raundeve, 21-vjeçari Jurgen Ulledaj ka triumfuar duke marrë fitoren me vendim unanim të tre gjyqtarëve. Kjo ishte ndeshja e tetë e të riut Jurgen Ulledaj në boks profesionist dhe fitorja e tetë në të njëjtën kohë. Dy nga tetë fitoret, ai i ka fituar me nokaut.



Frrokaj uron boksierin Jurgen Ulledaj për fitoren

Kryetari i Bashkisë Lezhë z.Fran Frrokaj ka uruar boksierin lezhjan Jurgen Ulledaj për fitoren e arritur pak ditë më parë në Gjermani. Frrokaj e priti 20 vjeçarin në zyrën e tij duke i shprehur konsideratën për rezultatet në emër të banorëve të Lezhës dhe jo vetëm. "Talentë të tillë krenojnë gjithë Shqipërinë, ndaj, Lezha i ka dhuruar sportit në tërësi një tjetër histori suksesi", nënvizoi kryebashkiaku Frrokaj. Boksieri Jurgen Ulledaj vlerësoi pritjen e bërë nga Bashkia Lezhë si i pari institucion në vend që e vlerëson për çmimin e fituar në Gjermani, ku shtoi se lezhjanët dhe Lezha do të mbeten gjithmonë një motiv edhe më i fortë në përpjekjet e tij për fitore të tjera. Jurgen Ulledaj u shpall kampion për peshat cruiserweight, duke marrë titullin "German International" përballë çekut Jakub Synek. 10 raunde të luftuara ku Jurgen Ulledaj arriti të hedhë në tapet kundërshtarin Synek.



Gëzuar 10 vjetorin, Kosovë!



Bashkia Lezhë,
Lagjia Skënderbeg,
Sheshi "Gjergj Kastrioti",
4501, Lezhë,
info@lezha.gov.al
www.lezha.gov.al